



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 6 tetor 2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303-

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Duda Balje.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: z. Ekrem Hoxha- Kryetar i bordit të ARKEP-it, Fatmir Gërvalla- ARKEP, Enis Berisha- Drejtor i përgjithshëm i ARH, Shkëlzen Qorri- ARH, Shefki Kastrati- NDI, Fjolla Uka- KDI, Genc Jaha- KDI, Besmir Kokollari- Instituti i CHAT, Qëndresa Mulaj- ZAP, Ibrahim Gylderren- ZAP, Zukë Zuka- ZAP dhe Blerta Bejtullahu- EUSR/EU Office.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zv. kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.09.2015;
3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;
4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014;
5. Të ndryshme.

Zv. kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Zv. kryetari - konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.09.2015

Zv. kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23.09.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Zv. kryetari për të arsyetuar të gjeturat nga raporti i auditivit të PVF-ve për ARKEP-in e hapi diskutimin dhe ia dha fjalën përfaqësuesve të ZAP-it.

Zukë Zuka- ARKEP- i është një institucion i vogël me buxhet, me një numër relativisht të vogël të punësuarve, të cilët kryejnë punë të rëndësishme në rregullimin e sektorit të telekomunikimit. Për pasqyrat financiare vjetore të vitit 2014, auditori i përgjithshëm ka një opinion të pakualifikuar. Ndërsa sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi ka qenë mirë, me disa përjashtime të cilat i kemi paraqitur në raportin vjetor. Nëse fillojmë nga implementimi i rekomandimeve të raportit të vitit paraprak të vitit 2013, shihet se ARKEP- i ka dhënë një rëndësi të veçantë implementimit të rekomandimeve, por megjithatë ende ka punë në implementimin e të gjitha rekomandimeve. Gjithsej nga 10 rekomandime, 3 prej tyre ishin implementuar kryesisht, 3 të tjera kanë mbetur pa u implementuar dhe 4 janë implementuar. Çështje tjetër që ka dalë nga auditimi që ka të bëjë me vitin 2014, është mos implementimi i disa projekteve kapitale, të cilat kryesisht kanë qenë për shkak të sfidës të cilën e kanë pasur, duke filluar nga një punonjës në zyrën e prokurimit, që ka munguar fillimisht, pastaj ndërkohë është përzgjedhur nga ARKEP- i, mandej kanë qenë edhe tri projekte të tjera, të cilat për shkak të mungesës së rregullores nuk janë aprovuar dhe tri projekte kanë qenë për shkak të vonesave në procedurat e prokurimit. Sfidë tjetër e ARKEP- it, ka qenë edhe themelimi i njësisë së auditorit të brendshëm, meqenëse me buxhet ARKEP- i i ka plotësuar kriteret për themelimin e njësisë së auditorit të brendshëm, por në vazhdimësi të buxhetit ARKEP- i prapë ka qenë nën limitin e buxhetit të cilin e ka shpenzuar për themelimin e njësisë, edhe pse janë marrë masa nga Ministria e Financave.

Ekrem Hoxha- Për ne, si ARKEP, leximi i raporteve të auditimit, tash e katër vjet janë pa asnjë vërejtje përmbajtësore, që ndikojnë në mirëmenaxhimin e mjeteve buxhetore. Sa i përket rekomandimeve, pajtohem edhe ne se ka pasur një ngecje kundrejt planifikimit, por po i referohem rekomandimit kryesor, që ka qenë nivel i ulët i realizimit të projekteve kapitale. Ne në komisionet funksionale, komisionin për zhvillim ekonomik dhe komisionin për buxhet dhe financa, kemi dorëzuar raport të hollësishëm për secilën nga katër projektet të cilat nuk janë realizuar gjatë vitit 2014, në ato katër projekte, tri projekte kanë qenë të ndërlydhura me mos përmbushjen e kriterëve nga faktorë tjerë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Punëve të Jashtme, ka edhe organe kompetente, mos marrja e kodit të internetit, kodit telefonik dhe nga këto dy mosrealizime të planifikimeve tona, ne nuk kemi mundur që të iniciojmë projektet për realizimin e projekteve të caktuara dhe ndërlydhshmëria e tyre është e evidente që ka

ndikuar në performancën e realizimit të projekteve. ARKEP- i obligohet që edhe vitet tjera të mbajë në planifikim këto projekte, për arsye se angazhimet janë permanente të rregullatorit dhe të shtetit për anëtarësimin në këto mekanizma, ne e konsiderojmë përmbushje mbajtjen e planifikimit buxhetor. Tek evidenca e shpenzimeve të automjeteve, ne me sugjerim të auditorit, kemi miratuar rregulloren e cila është e standardeve të larta, dhe kemi kontrollin absolut të shpenzimeve të derivateve. Ju njoftoj se autoriteti bën monitorimin në nivel vendi, me njësi të specializuara, të vetmen gjë që nuk e kemi bërë ka qenë analitika për shpenzimin. Ne kemi bërë si menaxhment, kemi siguruar se shpenzimet të jenë brenda kufirit dhe janë shumë më të ulëta se projeksionet, këtë vit i kemi nga 10.000 euro të projektuara, vitin e kaluar ka qenë prapë një mirëmenaxhim. Si zyrtar i institucionit, ju siguroj se autoriteti e mirëmenaxhon paratë publike dhe është fakt se vitin e kaluar kemi qenë të shoqëruar me një dukuri, ku menaxheri i zyrës së prokurimit, ka lëvizur në një institucion tjetër publik dhe e ka lënë institucionin tonë për më gjatë se pesë muaj pa menaxher prokurimi, ndërsa procedurat e rekrutimit në Kosovë po zgjasin dhe e kemi plotësuar atë me marrëveshje mirëkuptimi me komisionin e pavarur për media, si dy institucione të pavarura dhe e kemi arritur që të realizojmë buxhetin në masën 82% për vitin e kaluar. Sa i përket njësisë së auditimit të brendshëm, ne kemi kërkuar tash e katër vite të na miratohet një pozitë, por fatkeqësisht për shkak të kufizimeve nuk kemi pasur mirëkuptim, por është evidente fakti se për katër vjetët e fundit, kemi pasur shpenzime nën 1 milion euro, kështu që nuk ka qenë edhe si prioritet, por në tri vjetët e fundit ne kemi kërkuar nga njësia për auditimin e brendshëm të MF- ve, të bëjë auditimin e pavarur.

Hajdar Beqa- Është për tu vlerësuar raporti i auditimit i ARKEP- it, por megjithatë janë disa të gjetura që janë cekur edhe në raportin e auditorit të përgjithshëm, dua të ndalem te e gjetura, ku prej 10 rekomandimeve, thuhet që 3 nuk janë adresuar fare, cila është arsyeja që nuk janë adresuar këto rekomandime. Kemi edhe disa vërejtje të tjera, si dobësi në vlerësimin e ofertave, po ashtu te prokurimi në një rast te përpilimi i kontratës për ofertuesin fitues, a kanë ndikuar këto në dëmtimin e buxhetit të autoritetit. Gjithashtu një rast, te deklaratat për përcaktueshmërinë e fondeve janë nënshkruar në kohë jo të duhur dhe në fund, a ka në plan autoriteti i juaj, që ta formoj zyrën e auditorit të brendshëm, derisa në bazë të auditorit gjeneral i plotësoni kushtet të keni një auditim të brendshëm.

Adem Grabovci- Nga raportimi i auditorit del qartë se nga rekomandimet e mëhershme, 3 kanë mbetur pa u realizuar, të cilat nuk kanë mbetur me fajin e juaj, por për shkak të mungesës së ligjit. Do të ndalem te ekzekutimi i buxhetit, ku janë në pyete investimet kapitale, ju e keni buxhetin jo të madh, besoj nevojat i keni më të mëdha, sikur të ishit angazhuar në ekzekutimin më të mirë të buxhetit, me siguri do të kishit rritur cilësinë e punës tuaj, a mundeni të na tregoni pse ndodh kjo, nëse ju në vitin paraprak nuk e keni ekzekutuar në tërësi buxhetin, nuk keni të drejtë të kërkonit rritje të buxhetit.

Synavere Rysha- Te çështja që është paraqitur në raport, te procedurat e prokurimit, në një proces ka qenë çmimi i kontratës 3,645 euro, ndërsa krejt çka ju e keni raportuar, ka qenë vlera për 3.465, mirëpo në nenin 3.3 thuhet në raport që e keni shkruar, se ata nuk kanë të drejtë të kalojnë vlerën 10.000 euro, a mendoni se kjo është një shkelje sipas ligjit të prokurimit? Çështja tjetër, i keni bartë mjetet për projektet që keni menduar me i realizuar këtë vit apo vitin tjetër, a mendoni se me bartjen e mjeteve e keni dëmtuar buxhetin?

Ekrem Hoxha- Si organ i themeluar me Ligj, që i raporton Kuvendit, ne e kemi kryer detyrën tonë ligjore dhe kemi futur në të gjitha projeksionet buxhetore kërkesat buxhetore. Kuvendi nuk e ka miratuar atëherë, pse neve të na jepet rekomandim, kjo është një dilemë e parë, ose çështje tjetër te urdhërblerja, me udhëzuesin për menaxhimin e financave publike ka hyrë në mesin e vitit të kaluar. Ne prej momentit kur kanë hyrë, kemi filluar me i zbatuar, në momentin kur e kanë audituar një dosje, këta ju kanë referuar periudhës paraprake dhe ka përfunduar në raport. Po kthehem te pyetjet konkrete, tek ekzekutimi i buxhetit që pyeti deputeti Grabovci, domeni i internetit, ne tash e tri vjet po t'i shikoni pasqyrat tona financiare i kemi të buxhetuara x mjete, mbi bazën e specifikacionit tonë, se sa mjete duhet me i përmbushur kriteret e anëtarësimit dhe zhvillimin e softuerit në pasqyrat buxhetore. Mund të ju jap lajmin, se jemi në rrugë të duhur që në fund të këtij viti të marrim kodin e internetit. Ne si organ zbatues i këtyre politikave në sektorin e telekomunikimit, jemi të obliguar të kemi resurset në dispozicion për me i implementu këto detyrime. Çështja tjetër, regjistrimi i pajisjeve të telefonisë, ne kemi raportuar në komisionet funksionale se regjistrimi i email prek substancën e të drejtave themelore të individit dhe legjislacioni aktual në fuqi nuk e mundëson realizimin e atij projekti, MF- ve ka themeluar një grup punues, ku ne, si trup profesional, kemi qenë anëtarë të atij grupi punues dhe kemi thënë se

me këtë legjislacion, një projekt i tillë nuk mund të realizohet. Ne i kemi projektuar 150.000 euro në buxhet duke e dhënë këtë vërejtje dhe e kemi dërguar plus amandamentimin e ligjit për me e mundësuar këtë, kjo nuk ka ndodhur dhe ai proces u ndalua. Gjithashtu projekti për matjen e kualitetit të shërbimeve në internet, në dy tentativa për me e realizuar projektin, për shkak që është projekt kompleks, nuk ka ngjallur interesim në tregun ndërkombëtar, për shkak të madhësisë së tregut tonë dhe ne i kemi kryer të gjitha procedurat, por në aspektin menaxheres. Pyetje tjetër ishte nga deputeti Beqa, i cili i përmendi disa raste të prokurimit, edhe nga raporti i auditorit nuk konstatohet asnjë shkelje e vetme, këto janë rekomandime për kompletim të dokumentacionit, i cili në informacionin tim shkrimor ju ka siguruar auditorit gjersa ka qenë aty. Ndërsa te pyetja e deputetes Rysha, te bartja e buxhetit, ne nuk kemi bërë bartje të buxhetit, nuk e kemi atë të drejtë me ligj, ndërsa sa i përket projektit konkret që e ngriti, e merr fjalën zyrtari kryesor financiar.

Fatmir Gërvalla- Sa për sqarim, të gjitha kontratat që shkojnë me kuotim të çmimeve, nën 10.000 euro, ky nen ka mbetur si nen i cekur në kontratë paraprake, nuk ka pasur të bëjë me ndonjë shkelje, edhe pse realisht shuma prej 3.645 euro është brenda listës të kontratës.

Synavere Rysha- Unë e di se është një periudhë kohore, që mbasi të bëhet mbledhja e dokumentacionit dhe mbasi të përgatitet drafti i parë, duhet që të ju dorëzohet juve dhe ju brenda dy jave duhet që të jepni komentet e juaja, mandej ato komente duhet që të përfshihen brenda në raport, ndërsa këtu nuk janë përfshirë. E dyta, te çështja e kontratave që po thotë zyrtari financiar, vlera e kontratës është 3.645 euro, 10% i kësaj është 365 euro, nëse shkojmë me ligjin e ri që është 30%, vlera është diku 1.500 euro, prandaj nuk është në rregull.

Zv. kryetari- e falënderon Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, gjithashtu falënderon edhe përfaqësuesit e Autoritetit të Telekomunikacionit për arsyetimin e raportit të PVF-ve për ARKEP-in. Me këtë mbylli diskutimin.

Përfundim

Komisioni vendosi që Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të ARKEP-it për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, të mos adresohet për seancë plenare.

4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Zv. kryetari- Për të arsyetuar të gjeturat nga raporti i auditimit të PVF-ve për ARH e hapi diskutimin dhe ia dha fjalën përfaqësuesve të ZAP-it.

Zukë Zuka- Ky është një raport i shkurtë, me buxhet të vogël, gjatë auditimit e kemi vërejtur se rekomandimet e vitit paraprak, të gjitha janë implementuar, ndërsa për vitin aktual 2014 kanë qenë vetëm dy rekomandime, njëri ka qenë për planifikimin e drejtë të shpenzimeve, megjithëse ka qenë vlerë e vogël, por megjithatë procedurat e kërkojnë që të bëhet një klasifikim i këtyre shpenzimeve, dhe një rekomandim është për zbatimin e pasurisë në sistemin e pasurisë.

Enis Berisha- ARH- ja të gjitha rekomandimet e vitit paraprak i ka realizuar. Ne në planin e veprimit i kemi adresuar edhe dy të gjeturat dhe i kemi përmirësuar, kështu që besoj se realizimi i buxhetit është kryer në mënyrë profesionale dhe në mënyrën më të mirë të mundshme.

Adem Grabovci- Na mbetet që vetëm me e përshëndet punën e tyre, por edhe me kërkuar normalisht edhe angazhim më cilësor që me i evituar edhe këto lëshime që janë. Këtu po shihet që ekzekutimi i buxhetit të pagat dhe mëditjet, nuk është për shkak të fajit tuaj, në këtë rast kemi të bëjmë me Qeverinë dhe me Kuvendin, prandaj regjistrimi i pasurisë duhet të kryhet dhe çka ka mbetur, a mundeni të na jepni një sqarim më konkret.

Enis Berisha- Këtu ka qenë një vërejtje e auditorit për menaxhimin e materialit shpenzues për zyre në vlerë prej 1.000 euro. Ne i kemi zyret me qira, nuk kemi hapësirë të mjaftueshme dhe i kemi stoqet e ndara.

Synavere Rysha- Unë kam një çështje tjetër, në bazë të asaj që kemi dëgjuar në media, Banka Botërore ka ndarë një shumë diku rreth 40 milionë euro për Hekurudhat e Kosovës, si keni menduar të ndani këtë buxhet?

Enis Berisha- Ne, si autoritet, nuk kemi të bëjmë me investime, ne jemi autoritet që rregullojmë dhe mbikëqyrim dy kompani, Infrakosin dhe Treinkosin, në këtë rast këtu është përgjegjëse menaxheri i Infrakosit për investime në infrastrukturën hekurudhore. 40 milionë i kemi marrë si Qeveri e Republikës së Kosovës, me të cilat do të investohet në linjën Leshak-Hani i Elezit. Ne si autoritet i kemi mbikëqyrë këto investime, mirëpo nuk kemi kompetencë për këto investime.

Zv.kryetari e falënderon Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, gjithashtu falënderon edhe përfaqësuesit e Autoritetit të Hekurudhave për arsyetim të raportit.

Përfundim

Komisioni vendosi që Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të ZRH-ve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, të mos adresohet për seancë plenare.

5. Të ndryshme

Zv. kryetari- Njoftoi se javën e ardhshme, më 13 tetor, do të mbahet një punëtori e organizuar nga GIZ- i, me temën “Mbështetja e mëtejshme ndaj Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Mbikëqyrjen efektive të shpenzimeve publike, moderatore znj. Emma Kellner”. Me këtë mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Besnik Bislimi